



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 145 dt.10.10.1996

Në bazë të vendimit të KRRT Nr.23, dt.19.08.1996, Z.Donika Myhyrdarit i është miratuar sheshi i ndërtimit për një godinë 6 – 8 kat klinikë + banesë në rrugën “Muhamet Gjollesha” në tokë shtetërore. Për këtë truall, të interesuarve i është dhënë leje ndërtimi nga Rajoni Nr.2, për të cilën ka paguar detyrimet financiare karshi shtetit sipas tarifave të atij viti si dhe hipotekimin e tij për 300m². Ndërkohë s’ka vepruar pasi ka pritur njohjen e pronësisë e këtij trualli, e cila rezultoi e familjes Kika dhe komisioni këtë parcelë ja kompesoi diku tjetër dhe sot kjo tokë është e lirë. Duke u nisur nga aktiviteti si klinikë e vetme e specializuar për fëmijët që s’flasin edhe Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të dt.10.10.1996,

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e truallit në pronësi të mjekes Z.Donika Myhyrdari, me sipërfaqe 300m², duke u nisur nga aktiviteti si klinikë e vetme e specializuar për fëmijët që s’flasin.

KRYETARI

BESNIK PETRELA